



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/153
Datë: 26.07.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 korrik 2023, merr këtë:


V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/64, të datës 25 shkurt 2022 "Për zbatimin nga Republika e Kosovës të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për vendosje të sanksioneve ndaj Federatës Ruse dhe Bjellorusisë, në raport me situatën në Ukrainë"

1. Pika 1. e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/64, të datës 25 shkurt 2022, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim: Qeveria e Republikës së Kosovës, zbaton sanksionet e vendosura nga Këshilli i Bashkimit Evropian përmes:
 - 1.1. Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 269/2014 (17.03.2014), lidhur me masat shtrënguese ndaj veprimeve që minojnë dhe kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës, amandamentuar dhe zgjeruar me rregulloret zbatuese të Këshillit (EU) Nr. 2023/755 (13.04.2023), Nr. 2023/1215 (23.06.2023), Nr. 2023/1216 (23.06.2023), respektivisht Vendimit të Këshillit 2014/145/CFSP (17.03.2014), amandamentuar me vendimet: (CFSP) 2023/756 (13.04.2023), (CFSP) 2023/1218 (23.06.2023);
 - 1.2. Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 833/2014 (31.07.2014) lidhur me masat shtrënguese ndaj veprimeve destabilizuese të Rusisë lidhur me situatën në Ukrainë, amandamentuar dhe zgjeruar me rregulloret zbatuese të Këshillit (EU) Nr. 2023/1214 (23.06.2023), respektivisht Vendimit të Këshillit 2014/512/CFSP (31.07.2014), amandamentuar me vendimet: (CFSP) 2023/1217 (23.06.2023).
2. Të gjitha llojet e sanksioneve, emrat e individëve, entiteteve dhe produkteve të cilat janë të sanksionuara përmes akteve ligjore të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe anekseve përkatëse të cekura në pikën 1, konsiderohen pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
3. Masat shtrënguese do të jenë në fuqi, deri në një vendim tjetër dhe varësisht nga rrethanat mund të përditësohen, plotësohen apo ndryshohen.
4. Obligohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/142
Datë: 10.05.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 3, të Ligjit Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 maj 2023, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/64, të datës 25 shkurt 2022 "Për zbatimin nga Republika e Kosovës të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për vendosje të sanksioneve ndaj Federatës Ruse dhe Bjellorusisë, në raport me situatën në Ukrainë"

1. Pika 1, e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/64, të datës 25.02.2022, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim: Qeveria e Republikës së Kosovës, zbaton sanksionet e vendosura nga Këshilli i Bashkimit Evropian përmes:
 - 1.1. Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 269/2014, (17.03.2014), lidhur me masat shtrënguese ndaj veprimeve që minojnë dhe kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës, i amendamentuar dhe zgjeruar me rregulloret zbatuese të Këshillit (EU) Nr. 2023/192 (30.01.2023), Nr. 2023/253 (07.02.2023), Nr. 2023/426 (25.02.2023), Nr. 2023/429 (25.02.2023), Nr. 2023/571 (13.03.2023), respektivisht Vendimit të Këshillit 2014/145/CFSP, (17.03.2014), i amendamentuar me vendimet: (CFSP) 2023/193 (30.01.2023), (CFSP) 2023/261 (07.02.2023), (CFSP) 2023/432 (25.02.2023), (CFSP) 2023/572 (13.03.2023);
 - 1.2. Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 833/2014 (31.07.2014) lidhur me masat shtrënguese ndaj veprimeve destabilizuese të Rusisë lidhur me situatën në Ukrainë, e amendamentuar dhe zgjeruar me rregulloret zbatuese të Këshillit (EU), Nr. 2023/180 (27.01.2023), Nr. 2023/250 (04.02.2023), Nr. 2023/251 (04.02.2023), Nr.2023/427 (25.02.2023), Nr.2022/428 (15.03.2022), respektivisht Vendimit të Këshillit 2014/512/CFSP (31.07.2014), i amendamentuar me vendimet: (CFSP) 2023/191 (27.01.2023), (CFSP) 2023/252 (04.02.2023), (CFSP) 2023/434 (25.02.2023), (CFSP) 2022/430 (15.03.2022);
 - 1.3. Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 2022/263 në lidhje me masat kufizuese në përgjigje të njohjes së zonave të kontrolluara joqeveritare të rajoneve Donetsk dhe Luhansk të Ukrainës dhe urdhërimin e forcave të armatosura ruse në ato zona, e amendamentuar dhe zgjeruar me rregulloret zbatuese të Këshillit (EU) Nr. 2022/595 (11.04.2022), Nr. 2022/626 (13.04.2022), Nr. 2022/1903 (06.10.2022), respektivisht Vendimin e Këshillit 2022/266/(CFSP), i amendamentuar me Vendimin (CFSP) 2023/388 (20.02.2023);

- 1.4. Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 2017/1770 lidhur me masat shtrënguese ndaj situatës në Mali, dhe veprimeve të Grupit Wagner, e amendamentuar dhe zgjeruar me rregulloret zbatuese të Këshillit (EU) 2023/428 (25.02.2023), respektivisht Vendimit të Këshillit (CFSP) 2017/1775, i amendamentuar me Vendimin (CFSP) 2023/431 (25.02.2023);
- 1.5. Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 2020/1998, lidhur me masat shtrënguese kundër shkeljeve dhe abuzimeve të rënda të të drejtave të njeriut, e amendamentuar dhe zgjeruar me rregulloret zbatuese të Këshillit (EU) Nr. 2023/500 (07.03.2023), Nr. 2023/430 (25.02.2023), respektivisht Vendimit të Këshillit: (CFSP) 2020/1999, i amendamentuar me Vendimin (CFSP) 2023/501 (07.03.2023), (CFSP) 2023/433 (25.02.2023).
2. Të gjitha llojet e sanksioneve, emrat e individëve, entiteteve dhe produkteve të cilat janë të sanksionuara përmes akteve ligjore të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe anekseve përkatëse të cekura në pikën 1, konsiderohen pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
3. Masat shtrënguese do të jenë në fuqi, deri në një vendim tjetër dhe varësisht nga rrethanat mund të përditësohen, plotësohen apo ndryshohen.
4. Obligohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit, në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/136
Datë: 22.03.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 mars 2023, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 03/78, të datës 16 maj 2022, për vendosjen e masave kufizuese kundër Grupit Wagner - një entitet ushtarak privat i painkorporuar, me bazë në Rusi

1. Pika 1. e Vendimit të Qeverisë Nr. 03/78, të datës 16 maj 2022, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim: Qeveria e Republikës së Kosovës, zbaton sanksionet kundër Grupit Wagner, të vendosura nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës:
 - 1.1. Përmes Urdhrave Ekzekutiv Nr. 14024, 13667, 13581, 13660, 13863.
2. Të gjitha llojet e sanksioneve, emrat e individëve, entiteteve dhe produkteve të cilat janë të sanksionuara përmes akteve ligjore të SHBA-së dhe anekseve përkatëse të cekura në pikën 1. konsiderohen pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
3. Sanksionet do të jenë në fuqi, deri në një Vendim tjetër dhe varësisht nga rrethanat mund të përditësohen.
4. Obligohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit, në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 19/136
Datë: 22.03.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 mars 2023, merr këtë:


V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/64, të datës 25 shkurt 2022 "Për zbatimin nga Republika e Kosovës të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për vendosje të sanksioneve ndaj Federatës Ruse dhe Bjellorusisë, në raport me situatën në Ukrainë"

1. Pika 1. e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/64, të datës 25 shkurt 2022, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim: Qeveria e Republikës së Kosovës, zbaton sanksionet e vendosura nga Këshilli i Bashkimit Evropian përmes:
 - 1.1. Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 269/2014, (17.03.2014), lidhur me masat shtrënguese ndaj veprimeve që minojnë dhe kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës, amandamentuar dhe zgjeruar me rregulloret zbatuese të Këshillit (EU) Nr. 2022/1529 (14.09.2022), Nr. 2022/1906 (06.10.2022), Nr. 2022/1985 (20.10.2022), Nr. 2022/2475 dhe Nr. 2022/2476 (16.12.2022), respektivisht Vendimit të Këshillit 2014/145/CFSP, të datës 17 mars 2014, amandamentuar me vendimet (CFSP) 2022/1530 (14.09.2022), (CFSP) 2022/1907 (06.10.2022), (CFSP) 2022/1986 (20.10.2022), (CFSP) 2022/2477 dhe (CFSP) 2022/2479 (16.12.2022).
 - 1.2. Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 833/2014 (31.07.2014) lidhur me masat shtrënguese ndaj veprimeve destabilizuese të Rusisë lidhur me situatën në Ukrainë, amandamentuar dhe zgjeruar me rregulloret zbatuese të Këshillit (EU) Nr. 2022/1904, (06.10.2022), Nr.2022/2367 dhe Nr.2022/2368 (03.12.2022), Nr. 2022/2474 (16.12.2022), respektivisht Vendimit të Këshillit 2014/512/CFSP të datës 31.07.2014, amandamentuar me Vendimin (CFSP) 2022/1909 (06.10.2022), (CFSP) 2022/2369 (03.12.2022), (CFSP) 2022/2478 (16.12.2022).
 - 1.3. Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 765/2006 lidhur me situatën në Bjellorusi dhe përfshirjen e Bjellorusisë në agresionin Rus kundër Ukrainës, amandamentuar dhe zgjeruar me rregulloret zbatuese të Këshillit (EU) Nr. 2022/876, Nr. 2022/877 (03.06.2022), respektivisht Vendimit të Këshillit 2012/642/CFSP (15.10.2012), amandamentuar me vendimin (CFSP) 2022/881 dhe (CFSP) 2022/888 (03.06.2022).

- 1.4. Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 2022/263 në lidhje me masat kufizuese në përgjigje të njohjes së zonave të kontrolluara joqeveritare të rajoneve Donetsk dhe Luhansk të Ukrainës dhe urdhërimin e forcave të armatosura Ruse në ato zona, amandamentuar dhe zgjeruar me rregulloret zbatuese të Këshillit (EU) 2022/1903 (06.10.2022), respektivisht Vendimit të Këshillit 2014/266/CFSP, amandamentuar me Vendimin (CFSP) 2022/1908 (06.10.2022).
2. Të gjitha llojet e sanksioneve, emrat e individëve, entiteteve dhe produkteve të cilat janë të sanksionuara përmes akteve ligjore të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe anekseve përkatëse të cekura në pikën 1. konsiderohen pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
3. Masat shtrënguese do të jenë në fuqi, deri në një Vendim tjetër dhe varësisht nga rrethanat mund të përditësohen.
4. Obligohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit, në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 20/96
Datë: 14.09.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3. të Ligjit Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2022, merr këtë:


V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/64, të datës 25 shkurt 2022 "Për zbatimin nga Republika e Kosovës të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për vendosje të sanksioneve ndaj Federatës Ruse dhe Bjellorusisë, në raport me situatën në Ukrainë"

1. Pika 1. e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/64, të datës 25 shkurt 2022, plotësohet si në vijim: Qeveria e Republikës së Kosovës, zbaton sanksionet e vendosura nga Këshilli i Bashkimit Evropian përmes:
 - 1.1 Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 269/2014, (17.03.2014), lidhur me masat shtrënguese ndaj veprimeve që minojnë dhe kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës, amandamentuar dhe zgjeruar me rregulloret zbatuese të Këshillit (EU) Nr. 2022/878, Nr.2022/880 (03.06.2022), Nr.2022/1270 (21.07.2022), Nr.2022/1354 (04.08.2022), respektivisht Vendimit të Këshillit 2014/145/CFSP të datës 17 mars 2014, amandamentuar me vendimet (CFSP) 2022/883, (CFSP) 2022/885 (03.06.2022), (CFSP) 2022/1272 (21.07.2022), (CFSP) 2022/1355 (04.08.2022);
 - 1.2 Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 833/2014 (31.07.2014) lidhur me masat shtrënguese ndaj veprimeve destabilizuese të Rusisë lidhur me situatën në Ukrainë, amandamentuar dhe zgjeruar me rregulloret zbatuese të Këshillit (EU) Nr. 2022/879, (03.06.2022), Nr. 2022/1269 (21.07.2022), respektivisht Vendimit të Këshillit 2014/512/CFSP të datës 31.07.2014, amandamentuar me vendimin (CFSP) 2022/884 (03.06.2022), (CFSP) 2022/1271 (21.07.2022) dhe (CFSP) 2022/1313 (26.07.2022).
 - 1.3 Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 765/2006 lidhur me situatën në Bjellorusi dhe përfshirjen e Bjellorusisë në agresionin Rus kundër Ukrainës, amandamentuar dhe zgjeruar me rregulloret zbatuese të Këshillit (EU) Nr. 2022/876, Nr. 2022/877 (03.06.2022), respektivisht Vendimit të Këshillit 2012/642/CFSP (15.10.2012), amandamentuar me vendimin (CFSP) 2022/881 dhe (CFSP) 2022/888 (03.06.2022).
 - 1.4 Vendimit të Këshillit 2014/386/CFSP, lidhur me masat shtrënguese në përgjigje të aneksimit të paligjshëm të Krimesë dhe Sevastopolit, nga Federata Ruse, amandamentuar me vendimin (CFSP) 2022/962 (20.06.2022).

2. Të gjitha llojet e sanksioneve, emrat e individëve, entiteteve dhe produkteve të cilat janë të sanksionuara përmes akteve ligjore të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe anekseve përkatëse të cekura në pikën 1, konsiderohen pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
3. Masat shtrënguese do të jenë në fuqi, deri në një Vendim tjetër dhe varësisht nga rrethanat mund të përditësohen.
4. Obligohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit, në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/86
Datë: 04.07.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3, të Ligjit Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 4 korrik 2022, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 02/78, të datës 16 maj 2022 "Për zbatimin nga Republika e Kosovës të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për vendosje të sanksioneve ndaj Federatës Ruse dhe Bjellorusisë, në raport me situatën në Ukrainë"

1. Në pikën 1, 2 dhe 3, të Vendimit Nr. 02/78, të datës 16 maj 2022, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, bëhen këto shtesa dhe ndryshime /plotësime:
 - 1.1. Nën pikës 1.2 të Vendimit, i shtohen aktet nënligjore të BE-së si në vijim: Rregullorja zbatuese e Këshillit të Bashkimit Evropian (EU) Nr. 2022/427, së bashku me anekset përbërëse dhe Vendimi i Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2022/429, me anekset përbërëse.
 - 1.2. Nën pikës 1.3 të Vendimit, i shtohen aktet nënligjore të BE-së si në vijim: Rregullorja zbatuese e Këshillit të Bashkimit Evropian (EU) Nr. 2022/428, me anekset përbërëse dhe Vendimi i Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2022/430, me anekset përbërëse.
 - 1.3. Nën pika 2.6, e Vendimit ndryshohet/plotësohet me tekstin si në vijim: ndalim të importit të produkteve në Republikën e Kosovës, nëse ato janë me origjinë nga Rusia ose eksportohen nga Rusia, të listuara në anekset përkatëse të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, të cekura në pikën 1, nën pika 1.2 dhe 1.3 të Vendimit Nr. 02/78, të datës 16 maj 2022, ndryshuar/plotësuar me këtë Vendim.
 - 1.4. Pikës 2, të Vendimit i shtohet edhe nën pika 2.7 dhe 2.8, me këtë përmbajtje:
Ndalim të eksportit në lidhje me mallrat dhe teknologjinë me përdorim të dyfishtë, si dhe mallrat dhe teknologjinë që mund të kontribuojnë në përmirësimin teknologjik të sektorit të mbrojtjes dhe sigurisë së Rusisë, dhe mallra tjera të pasqyruara si në anekset e vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, të cekura në pikën 1, nën pika 1.2 dhe 1.3 të Vendimit Nr. 02/78, të datës 16 maj 2022, ndryshuar/plotësuar me këtë Vendim.
 - 1.5. Ndalim i investimeve të reja në sektorin energjetik rus, si dhe një ndalim gjithëpërfshirës i eksportit në pajisje, teknologji dhe shërbime për industrinë e energjisë në Rusi, me përjashtim të industrisë bërthamore dhe sektorit në rrjedhën e poshtme (downstream sector) të transportit të energjisë, të pasqyruara si në anekset e Vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, të cekura në pikën 1, nën pika 1.2 dhe 1.3 të Vendimit Nr. 02/78, të datës 16 maj 2022, ndryshuar/plotësuar me këtë Vendim.

- 1.6. Pika 3, e Vendimit ndryshohet / plotësohet me tekstin si në vijim: Emrat e individëve, entiteteve dhe produkteve ndaj të cilëve zbatohen sanksionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të përcaktuara si në pikën 2. të Vendimit, janë të listuara në Shtojcën nr. 1 dhe në anekset e vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, që janë pjesë përbërëse e Vendimit Nr. 02/78, të datës 16 maj 2022, ndryshuar/plotësuar me këtë Vendim.
2. Obligohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit, në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/78
Datë: 16.05.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 maj 2022, merr këtë:

V E N D I M

Për plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/64, të datës 25 shkurt 2022, i amandamentuar me Vendimin 13/68, të datës 23 mars 2022 "Për zbatimin nga Republika e Kosovës të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për vendosje të sanksioneve ndaj Federatës Ruse dhe Bjellorusisë, në raport me situatën në Ukrainë"

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, zbaton:


- 1.1 Sanksionet e vendosura nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës përmes urdhrave ekzekutiv 14024 (15.04.2021) dhe direktivave ligjore, që burojnë nga këto akte ligjore, në raport me situatën në Ukrainë; dhe
- 1.2 Sanksionet e vendosura nga Këshilli i Bashkimit Evropian përmes Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 269/2014, (17.03.2014), amandamentuar dhe zgjeruar me rregulloret zbatuese të Këshillit (EU) Nr. 2022/580, Nr.2022/581 (08.04.2022), respektivisht Vendimit të Këshillit 2014/145/CFSP të datës 17 mars 2014, amandamentuar me vendimet (CFSP) 2022/582; (08.04.2022), lidhur me masat shtrënguese ndaj veprimeve që minojnë dhe kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës;
- 1.3 Sanksionet ndaj veprimeve destabilizuese të Rusisë lidhur me situatën në Ukrainë të vendosura nga Këshilli i Bashkimit Evropian përmes Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 833/2014 (31.07.2014), amandamentuar dhe zgjeruar me rregulloret zbatuese të Këshillit (EU) Nr.2022/576, Nr.2022/577 (08.04.2022), respektivisht Vendimit të Këshillit 2014/512/CFSP të datës 31.07.2014, amandamentuar me vendimet (CFSP) 2022/578, (08.04.2022); dhe
- 1.4 Sanksione ndaj situatës në Bjellorusi dhe përfshirjes së Bjellorusisë në agresionin Rus kundër Ukrainës, të vendosura nga Këshilli i Bashkimit Evropian përmes Vendimit të Këshillit 2012/642/CFSP (15.10.2012), amandamentuar me Vendimin (CFSP) 2022/579 (08.04.2022).

2. Sanksionet konsistojnë në:

- 2.1. Ngrirje të aseteve në Republikën e Kosovës të individëve apo entiteteve të sanksionuara;
 - 2.2. Ndalim të qasjes dhe operimit në tregun financiar të Kosovës, të individëve apo entiteteve të sanksionuara;
 - 2.3. Ndalim udhëtimi në territorin e Republikës së Kosovës për individët e sanksionuar;
 - 2.4. Ndalim për individë dhe entitete në Republikën e Kosovës, që të vënë në dispozicion fonde, qoftë në mënyrë direkte ose indirekte, për individët dhe entitetet e sanksionuara;
 - 2.5. Ndalim për çdo ndërmarrje të transportit rrugor Rus dhe Bjellorus, që të transportojnë mallra përmes rrugëve brenda Kosovës përfshirë transitin. Përfshihet (produkte farmaceutike, mjekësore, bujqësore dhe ushqimore, duke përfshirë grurin, dhe për transportin rrugor për qëllime humanitare);
 - 2.6. Ndalim të importit nga Rusia të qymyrit dhe lëndëve të tjera djegëse të ngurta fosile në Kosovë, nëse ato janë me origjinë nga Rusia ose eksportohen nga Rusia.
3. Emrat e individëve dhe entiteteve, ndaj të cilëve zbatohen sanksionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të përcaktuara si në pikën 2. të këtij Vendimi, janë të listuara në Shtojcën Nr. 1, e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
 4. Sanksionet do të jenë në fuqi, deri në një Vendim tjetër dhe varësisht nga rrethanat mund të përditësohen.
 5. Obligohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
 6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit, në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/78
Datë: 16.05.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 maj 2022, merr këtë:

V E N D I M

Për vendosjen e masave kufizuese kundër Grupit Wagner - një entitet ushtarak privat i painkorporuar, me bazë në Rusi

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, zbaton sanksionet kundër Grupit Wagner - një entitet ushtarak privat i pa inkorporuar, me bazë në Rusi:
 - 1.1. Të vendosura nga Këshilli i Bashkimit Evropian përmes Rregullores së Këshillit (EU) Nr.269/2014, (17.03.2014), amandamentuar dhe zgjeruar me rregulloren zbatuese të Këshillit (EU) Nr.2021/2193 (13.12.2021), respektivisht Vendimit të Këshillit 2014/145/CFSP (17.03.2014), amandamentuar me Vendimin (CFSP) 2021/2196 (13.12.2021), lidhur me masat shtrënguese ndaj veprimeve që minojnë dhe kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës;
 - 1.2. Sanksionet ndaj shkeljeve dhe abuzimeve të të drejtave të njeriut të vendosura nga Këshilli i Bashkimit Evropian përmes Rregullores së Këshillit (EU) Nr.2020/1998 amandamentuar dhe zgjeruar me rregulloren zbatuese të Këshillit (EU) Nr. 2021/2195, (13.12.2021), respektivisht Vendimit të Këshillit (CFSP) 2020/1999, amandamentuar me Vendimin (CFSP) 2021/2197, (13.12.2021);
 - 1.3. Sanksione në lidhje me situatën në Libi të vendosura nga Këshilli i Bashkimit Evropian përmes Rregullores së Këshillit (EU) Nr.2016/44, amandamentuar dhe zgjeruar me rregulloren zbatuese të Këshillit (EU) Nr.2021/2192, (13.12.2021), respektivisht Vendimit të Këshillit (CFSP) 2015/1333, amandamentuar me Vendimin (CFSP) 2021/2198, (13.12.2021); dhe
 - 1.4. Sanksione në lidhje me situatën në Siri, të vendosura nga Këshilli i Bashkimit Evropian përmes Rregullores së Këshillit (EU) Nr.36/2012, amandamentuar dhe zgjeruar me rregulloren zbatuese të Këshillit (EU) Nr.2021/2194, (13.12.2021), respektivisht Vendimit të Këshillit (CFSP) 2013/255, amandamentuar me Vendimin (CFSP) 2021/2199, (13.12.2021).
2. Sanksionet konsistojnë në:
 - 2.1. Ngrirje të aseteve në Republikën e Kosovës të individëve apo entiteteve të sanksionuara;
 - 2.2. Ndalim udhëtimi në territorin e Republikës së Kosovës për individët e sanksionuar;

- 2.3. Ndalim për individë dhe entitete në Republikën e Kosovës, që të vënë në dispozicion fonde, qoftë në mënyrë direkte ose indirekte, për individët dhe entitetet e sanksionuara.
3. Emrat e individëve dhe entiteteve, ndaj të cilëve zbatohen sanksionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të përcaktuara si në pikën 2. të këtij Vendimi, janë të listuara në Shtojcën Nr. 1, e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
4. Sanksionet do të jenë në fuqi, deri në një Vendim tjetër dhe varësisht nga rrethanat mund të përditësohen.
5. Obligohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit, në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/78
Datë: 16.05.2022


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 maj 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, zbaton sanksionet e vendosura nga Këshilli i Bashkimit Evropian përmes Rregullores së Këshillit (EU) Nr.2016/1686, amendamentuar me Rregulloren e Këshillit (EU) Nr.2022/235 (21.02.2022), respektivisht Vendimit të Këshillit 2016/1693/CFSP, amendamentuar me Vendimin e Këshillit (CFSP) 2022/240 (21.02.2022), lidhur me marrjen e masave restriktive për terrorizëm ndaj ISIL (Da'esh) dhe Al-Qaeda, dhe personave fizikë dhe juridikë, subjekteve dhe strukturave tjera të lidhura me to.
2. Sanksionet konsistojnë në:
 - 2.1. Ngrirje të aseteve në Republikën e Kosovës të individëve apo entiteteve të sanksionuara;
 - 2.2. Ndalim udhëtimi në territorin e Republikës së Kosovës për individët e sanksionuar;
 - 2.3. Ndalim për individë dhe entitete në Republikën e Kosovës, që të vënë në dispozicion fonde, qoftë në mënyrë direkte ose indirekte, për individët dhe entitetet e sanksionuara.
3. Emrat e individëve dhe entiteteve, ndaj të cilëve zbatohen sanksionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të përcaktuara si në pikën 2. të këtij Vendimi, janë të listuara në Shtojcën Nr. 1, e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
4. Sanksionet do të jenë në fuqi, deri në një Vendim tjetër dhe varësisht nga rrethanat mund të përditësohen.
5. Obligohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit, në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR 
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/68
Datë: 23.03.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2022, merr këtë:

V E N D I M


Për plotësimin e vendimit të QRK Nr. 01/64, datë 25.02.2022 "Për zbatimin nga Republika e Kosovës të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për vendosje të sanksioneve ndaj Federatës Ruse dhe Bjellorusisë, në raport me situatën në Ukrainë"

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, zbaton:

- 1.1 Sanksionet e vendosura nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës përmes urdhrave ekzekutiv 14024 (15.04.2021), 13661 (19.03.2014), 13662 (24.03.2014) dhe direktivave ligjore, që burojnë nga këto akte ligjore, në raport me situatën në Ukrainë;
- 1.2 Sanksionet e vendosura nga Këshilli i Bashkimit Evropian përmes Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 269/2014, (17.03.2014), amendamentuar dhe zgjeruar me rregulloret zbatuese të Këshillit (EU) Nr. 2022/330, Nr.2022/332 (25.02.2022), Nr. 2022/336 (28.02.2022), Nr. 2022/353 (02.03.2022), Nr. 2022.396 (09.03.2022) respektivisht Vendimit të Këshillit 2014/145/CFSP të datës 17 mars 2014, amendamentuar me vendimet (CFSP) 2022/329; (CFSP) 2022/331 (25.02.2022), (CFSP) 2022/337 (28.02.2022), (CFSP) 2022/354 (02.03.2022), (CFSP) 2022/397 (09.03.2022), lidhur me masat shtrënguese ndaj veprimeve që minojnë dhe kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës;
- 1.3 Sanksionet ndaj veprimeve destabilizuese të Ruisë lidhur me situatën në Ukrainë të vendosura nga Këshilli i Bashkimit Evropian përmes Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 833/2014 (31.07.2014), amendamentuar dhe zgjeruar me rregulloret zbatuese të Këshillit (EU) Nr. 2022/328 (25.02.2022), Nr. 2022/334 (28.02.2022), Nr. 2022/345, Nr. 2022/350 (01.03.2022), Nr. 2022.394 respektivisht Vendimit të Këshillit 2014/512/CFSP të datës 31.07.2014, amendamentuar me vendimet (CFSP) 2022/327 (25.02.2022), (CFSP) 2022/335 (28.02.2022), (CFSP) 2022/346, (CFSP) 2022/351 (01.03.2022); (CFSP) 2022/395 (09.03.2022), dhe
- 1.4 Sanksione ndaj situatës në Bjellorusi dhe përfshirjes së Bjellorusisë në agresionin Rus kundër Ukrainës, të vendosura nga Këshilli i Bashkimit Evropian përmes Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 765/2006 (18.05.2006), amendamentuar dhe zgjeruar me rregulloret zbatuese të Këshillit (EU) Nr. 2022/355 (02.03.2022), Nr. 2022.398 (09.03.2022), respektivisht Vendimit të Këshillit 2012/642/CFSP (15.10.2012), amendamentuar me vendimet (CFSP) 2022/356 (02.03.2022), (CFSP) 2022/399 (09.03.2022)

2. Sanksionet konsistojnë në:
 - 2.1. Ngrirje të aseteve në Republikën e Kosovës të individëve apo entiteteve të sanksionuara;
 - 2.2. Ndalim të qasjes dhe operimit në tregun financiar të Kosovës, të individëve apo entiteteve të sanksionuara;
 - 2.3. Ndalim i transmetimit të mediave propaganduese të Rosisë në Republikën e Kosovës;
 - 2.4. Ndalim udhëtimi në territorin e Republikës së Kosovës për individët e sanksionuar;
 - 2.5. Ndalim për individë dhe entitete në Republikën e Kosovës, që të vënë në dispozicion fonde, qoftë në mënyrë direkte ose indirekte, për individët dhe entitetet e sanksionuara.
3. Emrat e individëve dhe entiteteve, ndaj të cilëve zbatohen sanksionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të përcaktuara si në pikën 2. të këtij Vendimi, janë të listuara në Shtojcën nr. 1, e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
4. Sanksionet do të jenë në fuqi deri në një vendim tjetër, dhe varësisht nga rrethanat mund të përditësohen.
5. Obligohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit, në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 29/68
Datë: 23.03.2022


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, zbaton:
 - 1.1. Sanksionet e vendosura nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, përmes Urdhërit Ekzekutiv Nr. 13818, ndaj personave dhe subjekteve të sanksionuara për krim të organizuar dhe shkelje të të drejtave të njeriut.
2. Sanksionet konsistojnë në:
 - 2.1. Sanksione financiare ndaj individëve apo entiteteve të sanksionuara;
 - 2.2. Ngrirje të aseteve në Republikën e Kosovës të individëve apo entiteteve të sanksionuara;
 - 2.3. Ndalim për individë dhe entitete në Republikën e Kosovës, që të vënë në dispozicion fonde, qoftë në mënyrë direkte ose indirekte, për individët dhe entitetet e sanksionuara.
3. Emrat e individëve dhe entiteteve, ndaj të cilëve zbatohen sanksionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të përcaktuara si në pikën 2. të këtij Vendimi, janë të listuara në Shtojcën nr. 1. e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
4. Sanksionet do të jenë në fuqi, deri në një Vendim tjetër dhe varësisht nga rrethanat mund të përditësohen.
5. Obligohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/64
Datë: 25.02.2022


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 shkurt 2022, meirr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, vendosë sanksione në përputhje me sanksionet e vendosura nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe sanksionet e vendosura nga Këshilli i Bashkimit Evropian përmes Rregullores së Këshillit (EU) Nr.269/2014 të datës 17 mars 2014, të amendamentuar me Rregulloren e Këshillit (EU) Nr. 2022/259, dhe të zgjeruar me Rregulloret Zbatuese të Këshillit Nr.2022/260, Nr.2022/261, të datës 23.02.2022, respektivisht Vendimit të Këshillit 2014/145/CFSP të datës 17 mars 2014 të amendamentuar me Vendimet e Këshillit (CFSP) 2022/241; (CFSP) 2022/265; (CFSP) 2022/267, lidhur me masat shtrënguese ndaj veprimeve që minojnë dhe kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës.
2. Sanksionet konsistojnë në:
 - 2.1. Ngrirje të aseteve në Republikën e Kosovës të individëve apo entiteteve të sanksionuara;
 - 2.2. Ndalim udhëtimi në territorin e Republikës së Kosovës për individët e sanksionuar;
 - 2.3. Ndalim për individë dhe entitete në Republikën e Kosovës, që të vënë në dispozicion fonde, qoftë në mënyrë direkte ose indirekte, për individët dhe entitetet e sanksionuara.
3. Emrat e individëve dhe entiteteve të sanksionuara janë ato listuara në anekset e akteve rregullative të Këshillit të Bashkimit Evropian referuar në pikën 1. të këtij Vendimi.
4. Sanksionet do të jenë në fuqi, deri në një Vendim tjetër dhe varësisht nga rrethanat mund të përditësohen.
5. Obligohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/61

Datë: 09.02.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 shkurt 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, zbaton sanksionet e vendosura nga Këshilli i Bashkimit Evropian, në bazë të Rregullores Implementuese të Këshillit (EU) 2021/997, të datës 21 qershor 2021, respektivisht Vendimit Zbatues të Këshillit (CFSP) 2021/1002, të datës 21 qershor 2021, me anë të së cilit Këshilli Evropian zgjeron listën ekzistuese të masave kufizuese në kuadër të Vendimit 2012/642/CFSP, të datës 15 tetor 2012, lidhur me situatën në Bjellorusi.
2. Sanksionet e lartshënuara konsistojnë në:
 - 2.1. Ngrirje të aseteve në Republikën e Kosovës për 183 (njëqind e tetëdhjetë e tre) individë dhe 26 (njëzetegjashtë) entitete;
 - 2.2. Ndalim të udhëtimit për individët e sanksionuar; dhe
 - 2.3. Ndalim për individë dhe entitete në Republikën e Kosovës, që të vënë në dispozicion fonde, qoftë në mënyrë direkte ose indirekte, për individët dhe entitetet e sanksionuara.
3. Emrat e individëve dhe entitetit ndaj të cilëve zbatohen sanksionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të përcaktuara në pikën 2. të këtij Vendimi, janë të listuara në Shtojcën nr. 1, e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
4. Sanksionet do të jenë në fuqi deri në një Vendim tjetër dhe varësisht nga rrethanat mund të përditësohen.
5. Obligohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/42
Datë: 27.10.2021


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 tetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës zbaton sanksionet e vendosura nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës konform Rezolutës 1373 të Këshillit të Sigurimit të OKB-ës për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare ndaj shtatë (7) individëve të lidhur me Hezbollah dhe kompaninë AIDar Properties, për të parandaluar financimin e akteve terroriste dhe për të ngrirë pasuritë financiare të organizatës terroriste Hezbollah ose mbështetësve të saj në Republikën e Kosovës.
2. Sanksionet e lartshënuara konsistojnë në:
 - 2.1. Ngritje të aseteve në Republikën e Kosovës për individët dhe entitetin e sanksionuar;
 - 2.2. Ndalim të udhëtimit për individët e sanksionuar; dhe
 - 2.3. Ndalim për individë dhe entitete në Republikën e Kosovës, që të vënë në dispozicion fonde, qoftë në mënyrë direkte ose indirekte, për individët dhe entitetin e sanksionuar.
3. Emrat e individëve dhe entitetit ndaj të cilëve zbatohen sanksionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të përcaktuara si në pikën 2. të këtij vendimi, janë të listuara në Shtojcën nr. 1, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Sanksionet do të jenë në fuqi deri në një vendim tjetër dhe varësisht nga rrethanat mund të përditësohen.
5. Obligohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/17
Datë: 25.06.2021


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 qershor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës zbaton sanksionet e vendosura nga Këshilli i Bashkimit Evropian, në bazë të Rregullores Implementuese të Këshillit (EU) 2021/612 të datës 15 prill 2021, respektivisht Vendimit (CFSP) 2021/613 të datës 15 prill 2021, me anë të së cilit Këshilli Evropian zgjeron listën ekzistuese të masave kufizuese në kuadër të Vendimit (CFSP) 2016/1693, të datës 20 shtator 2016, në lidhje me masat kufizuese kundër ISIL (Da'esh) dhe Al-Qaeda dhe personave, grupeve dhe entiteteve që kanë lidhje me këto organizata terroriste.
2. Sanksionet e lartshënuara konsistojnë në:
 - 2.1. Ngrirje të aseteve në Republikën e Kosovës për individët e sanksionuar;
 - 2.2. Ndalim të udhëtimit për individët e sanksionuar; dhe
 - 2.3. Ndalim për persona dhe entitete në Republikën e Kosovës, që të vënë në dispozicion fonde, qoftë në mënyrë direkte ose indirekte, për individët dhe entitetet e sanksionuara.
3. Emrat e individëve ndaj të cilëve zbatohen sanksionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të përcaktuara si në pikën 2. të këtij vendimi, janë të listuara në Shtojcën nr. 1. e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Zbatimi i sanksioneve ndërkombëtare të përcaktuara me këtë vendim, vlen deri me datën e përcaktuar në Vendimin (CFSP) 2016/1693, të datës 20 shtator 2016, i plotësuar me Vendimin (CFSP) 2021/613 të Këshillit të Bashkimit Evropian, të datës 15 prill 2021.
5. Obligohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/17
Datë: 25.06.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 qershor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës zbaton sanksionet e vendosura nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës konform Rezolutës 1373 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare, ndaj shtatë (7) shtetasve libanezë, të lidhur me Hezbollah dhe kompaninë e saj financiare Al-Qard al-Hassan (AQAH), për të parandaluar financimin e akteve terroriste dhe për të ngrirë pasuritë financiare të terroristëve të Organizatës terroriste Hezbollah-ut ose mbështetësve të saj në Republikën e Kosovës.
2. Sanksionet e lartshënuara konsistojnë në:
 - 2.1. Ngrirje të aseteve në Republikën e Kosovës për individët dhe entitetin e sanksionuar;
 - 2.2. Ndalim të udhëtimit për individët e sanksionuar; dhe
 - 2.3. Ndalim për persona dhe entitete në Republikën e Kosovës, që të vënë në dispozicion fonde, qoftë në mënyrë direkte ose indirekte, për individët dhe entitetet e sanksionuara.
3. Emrat e individëve dhe entitetit ndaj të cilëve zbatohen sanksionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të përcaktuara si në pikën 2. të këtij vendimi, janë të listuara në Shtojcën nr. 1. e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Sanksionet do të jenë në fuqi deri në një vendim tjetër dhe varësisht nga rrethanat mund të përditësohen.
5. Obligohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/11
Datë: 07.05.2021


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-183, për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 maj 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës zbaton sanksionet e vendosura nga Këshilli i Bashkimit Evropian, përmes vendimit (CFSP) 2013/184, të Këshillit të Bashkimit Evropian, të datës 22 Prill 2013 lidhur me disa masa restriktive bazuar në situatën në Myanmar/Burma, të ndryshuar dhe plotësuar me vendimet (CFSP) 2021/482 dhe (CFSP) 2021/483, të datës 22 Mars 2021, dhe vendimit (CFSP) 2021/639, të datës 19 prill 2021, ndaj tridhjetëepesë (35) zyrtarëve dhe dy (2) entiteteve të Myanmar/Burma, të përfshirë në abuzime dhe shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Myanmar/Burma.
2. Sanksionet e lartcekura konsistojnë në:
 - 2.1. Ngrirje të aseteve në Republikën e Kosovës për individët dhe entitetin e sanksionuar;
 - 2.2. Ndalim të udhëtimit për individët e sanksionuar, dhe
 - 2.3. Ndalim për persona dhe entitete në Republikën e Kosovës, që të vëjnë në dispozicion fonde, qoftë në mënyrë direkte ose indirekte, për individët dhe entitetet e sanksionuara.
3. Emrat e individëve dhe entiteteve ndaj të cilëve zbatohen sanksionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të përcaktuara si në pikën 2. të këtij vendimi, janë të listuara në Shtojcën nr. 1. e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Zbatimi i sanksioneve ndërkombëtare të përcaktuara me këtë vendim vlen deri me datën e përcaktuar në Vendimin (CFSP) 2013/184 të Këshillit të Bashkimit Evropian, të datës 22 Prill 2013 lidhur me masa restriktive kundër Myanmar/Burma, të ndryshuar dhe plotësuar me vendimet (CFSP) 2021/482 dhe (CFSP) 2021/483, të datës 22 Mars 2021 dhe vendimit (CFSP) 2021/639, të datës 19 prill 2021.
5. Obligohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/03
Datë: 02.04.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës zbaton sanksionet e vendosura nga Këshilli i Bashkimit Evropian përmes Vendimit (CFSP) 2021/481 e Këshillit të Bashkimit Evropian, të datës 22 mars 2021, i cili ndryshon dhe plotëson Vendimin (CFSP) 2020/1999 në lidhje me masat kufizuese kundër shkeljeve serioze të të drejtave të njeriut dhe abuzimeve, të datës 7 dhjetor 2020, ndaj katër (4) personave dhe një (1) entiteti kinez, të përfshirë në abuzime dhe shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, në Xinjiang.
2. Sanksionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të përcaktuar si në pikën 1, të këtij vendimi, janë të listuara në shtojcën Nr. 1, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Zbatimi i sanksioneve ndërkombëtare të përcaktuara me këtë vendim vlen deri me datën e përcaktuar në Vendimin (CFSP) 2020/1999 në lidhje me masat kufizuese kundër shkeljeve serioze të të drejtave të njeriut dhe abuzimeve, të datës 7 dhjetor 2020, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin (CFSP) 2021/481 e Këshillit të Bashkimit Evropian, të datës 22 mars 2021.
4. Obligohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/66
Datë: 23.02.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, nenit 18, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-198 për Tregtinë me Mallra Strategjike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 shkurt 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Zbatohen sanksionet ekonomike ndërkombëtare ndaj entiteteve dhe personave fizikë, të përcaktuar sipas listave të sanksioneve, të vendosura nga: Organizata e Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.
2. Sanksionet nga pika 1. e këtij vendimi, zbatohen me qëllim të ruajtjes së interesave kombëtare të Republikës së Kosovës, si dhe pjesëmarrjes aktive në përpjekjet për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.
3. Sanksionet nga pika 1. e këtij vendimi zbatohen që nga hyrja në fuqi e këtij vendimi dhe vazhdojnë deri në një vendim tjetër, si dhe varësisht nga rrethanat mund të përditësohen.
4. Obligohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi në pajtim me legjislacionin në fuqi.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Aklorit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/05
Datë: 06.03.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3 të Ligjit nr. 03/L-183 për zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 mars, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës mbështet sanksionet e caktuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara dhe Bashkimi Evropian, lidhur me Kompanitë, "SABALAN COMPANY - IRAN" e cila është në bashkëveprim me kompaninë "SHAHID HEMAT INDUSTRIAL GROUP - SHIG".
2. Zbatimi i sanksioneve të përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi, mbetet në fuqi deri sa kompanitë në fjalë të mbeten pjesë e listës së Sanksioneve të OKB-së dhe BE-së.
3. Obligohet Dogana e Republikës së Kosovës që të ndalojë importin dhe të kthejë mallin tek eksportuesi i huaj.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/08
Datë: 23.06.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 qershor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, me qëllim të ruajtjes së sigurisë kombëtare, rajonale dhe globale, mbrojtjes së interesave shtetërore dhe pjesëmarrjes aktive në Aleancat Ndërkombëtare të luftimit të grupeve terroriste.
2. Duke kontribuar në vazhdimin e bashkëpunimit të ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës si aleat i ngushtë strategjik, Bashkimin Evropian dhe partnerët e tjerë për eliminimin e rreziqeve që i kanosen Republikës së Kosovës dhe partnerëve të saj.
3. Vendos që Organizatën Globale Terroriste "Hezbollah" krahun e saj *politik dhe ushtarak*, ta shpallë si Organizatë terroriste në territorin e Republikës së Kosovës.
4. Obligohen organet përgjegjëse të sigurisë të Republikës së Kosovës që në pajtim me praktikat ndërkombëtare të ndërmarrin masat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/196
Datë: 17.09.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 3 të Ligjit Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, si dhe nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2011 dhe nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 shtator 2014, mori këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës mbështet sanksionet e Institucioneve të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës ndaj entiteteve juridike dhe autoriteteve të Federatës Ruse.
2. Sanksionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, janë përcaktuar në Shtojcën nr. 1. bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Sanksionet do të jenë në fuqi deri në një vendim tjetër dhe varësisht nga rrethanat mund të përditësohen.
4. Ngarkohen Ministria e Financave, Banka Qendrore, Njësia e Inteligjencës Financiare dhe institucionet e tjera përgjegjëse, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë